



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:016962

Datë: 27.12.2018

Numri i dokumentit: 00196889

**P.nr. 996/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues, Zyhdi Haziri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.V. nga fshati ..., K. e Prishtinës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Përgjithshme, PP.nr.1539/2017, të datës 20.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 27.12.2018, bie dhe publikisht shpall këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari A.V., nga i ati B. dhe nëna E., e lindur G., i lindur më datë ..., nga fshati ..., K. e Prishtinës, me vendbanim të përkohshëm në Gjermani, i martuar, nuk ka fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, punon në Gjermani – Mynhen, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**I.**

Sepse, më datë 24.08.2017, rreth orës 23:30 minuta, në Gjilan, saktësisht në rr “ ... ”, përballë Shtëpisë së Shëndetit “ ... ”, i pandehuri derisa e drejtonte automjetin e markës “Seat Ibiza”, me tabela regjistrimi ..., nga pakujdesia shkel ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor nga neni 54 paragrafi 1, pika 1.2, sipas së cilës dispozitë drejtuesi i automjetit duhet të mbajë distancën e nevojshme, nga mjeti para tij aq sa është e nevojshme për të iu shmangë goditjes së këtij mjeti nëse i njëjti frenon apo ndalet dhe mos respektimi i kësaj dispozite i

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

pandehuri me pjesën e përparme të automjetit të anës së djathtë të tij, me atë rast me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit të tij, e godet në pjesën e prapme të majtë automjetin “BMË X70”, me tabela të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte i dëmtuari P.F. dhe nga kjo goditje përveç dëmeve materiale në të dy automjetet, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari P.F., i cili për shkak të lëndimeve të pësura detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në QË të Gjilanit.

- Me çka ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 7, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale<sup>2</sup>, i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **A.V.**, për veprën penale sipas dispozitivit nën I. të këtij aktgjykimi, dënim me gjobë në shumë prej **400 € (katërqind) euro**, të cilin dënim i akuzuari do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari P.F., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të Kompensimit të Viktimave të Krimit, të paguajë shumën prej **30 € (tridhjetë) euro**.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej **15 € (pesëmbëdhjetë) euro**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 1539/2017, të datës 20.09.2017, ndaj të akuzuarit A.V. nga fshati ..., K. e Prishtinës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Në seancën fillestare të datës 27.12.2018, i akuzuari A.V. e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurorja Leonora Shemsiu-Kadriu, ka delaruar se meqë në shqyrtimin e sotëm fillestar, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, pa asnjë lloj ndikimi apo presioni, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë,

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

rezulton se është vërtetuar gjendja faktike si në aktiz akuzues, andaj i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë për kryerjen e kësaj veprë penale dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim meritoh sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në mënyrë që me dënimin e shqiptuar të arrihet edhe qëllimi i tij, i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

## 2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjatë seancës gjyqësore, i akuzuari A.V., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën e lartcekur dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale, i vie keq për atë që ka ndodhur ditën kritike dhe ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë vozitjes dhe nuk do të bie ndesh me ligjin, duke kërkuar nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim më të butë, mundësisht dënim me gjobë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban kjo aktakuzë dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar dhe vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari A.V., ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës.

Si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që ta shpallë fajtor të akuzuarin A.V., për kryerjen e veprës penale të lartcekur, ngase ka ardhur në përfundim se veprimet e tij përmbajnë të gjitha elementet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 378 paragrafi 6 të KPRK-së, është paraparë se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”, ndërsa në paragrafin 1 të të njëjtit nen, thuhet se “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”

## 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas neneve 73

dhe 74 të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese, gjyqtari i vetëm gjykues ka marrë për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, moshën e tij relativisht të re, pendimin për kryerjen e kësaj veprë penale, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Ndërsa, si rrethana rënduese, kryetari i trupit gjykues ka marrë për bazë rrezikshmërinë e kësaj veprë dhe dëmin e shkaktuar.

6. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit A.V., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lart, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 par.1. të KPPK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 15 € (pesëmbëdhjetë) euro dhe 30 € (tridhjetë) euro në emër të Kompensimit të Viktimave të Krimin, si dhe shpenzimet e procedurës që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.996/17, më 27.12.2018**

**Sekretarja Juridike**  
Naile Neziri

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Zyhdi Haziri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Prokurori i Shtetit dhe i akuzuari kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë, që do të thotë se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm më datë të sotme.